

**Takim pune i ekipit menaxhues të projektit në kuadër të Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) për “zvogëlim të pagesave në para të gatshme në Kosovë”**

Procesverbali i mbledhjes

**Ref. 3/2011**

**Vendi:** Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)

**Data:** 15 qershor 2011

**Koha:** 11:00 – 12:10

**Pjesëmarrësit:**

**Robert Wright**, Shef Kryesor Ekzekutiv, RBKO (*kryesues*)  
**Gjylfidane Kadrijaj**, Drejtore e Sistemeve Ndërbankare të Pagesave, BQK  
**Rinor Gjonbalaj**, Zyrtar i Mbikëqyrjes DSNP, BQK  
**Diturie Hoxha**, Drejtore Ekzekutive, SHBK  
**Edmond Jashari**, Zyrtar i lartë i menaxhimit të marketingut, TEB  
**Naim Gashi**, Menaxher i Thesarit, PTK Sh.A  
**Mentor Mikullovc**i, Drejtor i Sektorit të kartelave dhe e-banking, NLB  
**Akile Cërnobregu**, Udhëheqëse e Departamentit të Pagesave, PCB  
**Teuta Gazideda**, Menaxhere e CM&TMO, RBKO  
**Milot Kelmendi**, Menaxher i Performancës dhe Analizës, KEK  
**Makfire Osmani**, Menaxhere ekzekutive për marrëdhënie me klient, KUR "Prishtina"  
**Shyqeri Krasniqi**, Menaxher Ekzekutiv i Shitjes, KUR "Prishtina"

Munguan:

**Samir Lleshi**, Ekspert për çështje Fiskale dhe Financiare, OEK (*mungoi me njoftim paraprak*)

Takimi u fillua në ora 11:00.

Znj. Gjylfidane Kastrati-Kadrijaj, hapi takimin dhe falënderoj kryesuesin e grupit punues, z. Robert Wright, të gjithë të pranishmit për pjesëmarrje, dhe veçanërisht Diturie Hoxhën nga SHBK për punën e tyre për analizën hulumtimtuese për pagesa jo në para të gatshme.

**Diskutimet dhe prezantimet**

- **Miratimi i procesit dhe konkluzioneve të takimit të fundit**

Anëtarët miratuan njëzëri procesverbalin e takimit paraprak të mbajtur më 26 janar 2011.

Z. Robert Wright informojë të pranishmit për vendimin e marrë nga ekipi punues në takimin e kaluar, dhe miratimin nga KKP për plotësimin e ekipit menaxhues të projektit me dy anëtarë të rinj nga ATK dhe MPMS dhe sipas nevoje plus një nga Thesari.

- **Prezantim nga analiza dhe rezultatet e projektit studimor për pagesa jo në para të gatshme (hulumtim për klientin dhe tregtarin)**

Z. Robert Wright prezantoi para të pranishmëve analizën dhe rezultatet e projektit studimor për pagesa jo në para të gatshme (*shih prezantimin e bashkangjitur*). Hulumtimi kishte për qëllim identifikimin e arsyeve për përdorimin e madh të pagesave në para të gatshme nga klientët dhe komuniteti i biznesit. Studimi është kryer përmes anketimit të drejtpërdrejtë të klientëve dhe bizneseve.

Disa nga gjetjet kryesore nga anketimi i klientëve:

- Mungesë e theksuar e ndërgjegjësimit të klientëve me mënyrat e pagesave jo-cash
- Kartelat përdoren rrallë (në 59.5% të rasteve vetëm 1-5 herë në muaj) më së shumti për të tërhequr para të gatshme nga терминаlet ATM
- 56.9% e paguesve të faturave paguajnë në sportele të kompanive

Disa nga gjetjet kryesore nga anketimi i bizneseve:

- Vetëm 15.3% e bizneseve kanë terminale POS
- Mungesë e theksuar e ndërgjegjësimit të bizneseve me mënyrat e pagesave jo-cash
- Shumica e bizneseve janë të vogla dhe sillen në mënyrë të ngjashme sikurse individët

Konkluzionet fillestare nga studimi për përdorimin e vogël të pagesave jo në para të gatshme:

- Frika e teknologjisë, proceseve bankare, mungesa e kontrollit
- Mungesa e ndërgjegjësimit për mënyrat e tjera të pagesave
- Nevoja për bankat dhe kompanitë publike për të edukuar dhe nxitur klientët e tyre
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi i sektorit të biznesit për kostot dhe përfitimet e biznesit të tyre
- Mjedisi ekonomik ndikon në sjellje
- Ekziston potencial i madh – pajtim i gjerë se pagesat jo në para të gatshme janë të dobishme
- Është e nevojshme një rrjetë më e gjerë e terminaleve POS

- **Pyetje, kërkesa dhe propozime**

Znj. Diturie Hoxha informoj të pranishmit për disa nga problemet gjatë kryerjes së studimit.

Tek klientët/individët, grupi i synuar i mostrës kanë qenë njerëzit me të ardhura, që rrjedhimisht janë edhe posedues të llogarive bankare. Përgjigjet e të anketuarve kanë ndryshuar shumë në bazë të shpjegimeve të dhëna nga ana e anketuesit. Problemi kryesor tek kjo pjesë e të anketuarve, ka

qenë diferencimi në mes të njohjes me një mënyrë të pagesës dhe përdorimit të saj. Në përgjithësi të anketuarit nuk kanë qenë të njohur me mënyrat e pagesave.

Tek bizneset, problemi kryesor gjatë anketimit ka qenë ngurrimi i bizneseve për tu përgjigjur. Ngurrimi ka qenë edhe më i madh tek pyetjet si shuma e qarkullimit vjetor të biznesit. Por, në përgjithësi, sikurse tek anketimi i klientëve/individëve, bizneset nuk kanë qenë të njohur me alternativat e kryerjes së pagesave.

### **Propozime nga z. Robert Wright**

1. Duhet një vetëdijesim dhe edukimi i publikut në përgjithësi
  - Kush duhet të bëjë këtë kampanjë (Bankat komerciale, komuniteti i biznesit, institucionet qeveritare, apo Banka Qendrore)?
  - Kush duhet të paguaj për çka?
2. Nxitja e klientëve përmes tarifave për të përdorur pagesat jo në para të gatshme
  - A duhet bërë kjo nga institucionet individualisht apo si grup?
3. Rritja e rrjetës së terminaleve POS

### **Konkluzionet Takimit dhe Hapat e ardhshëm**

- Takimi i ardhshëm e ekipit do të mbahet në fillim të muajit shtator.
- Prezantimi i sotëm do t'ju dërgohet të gjithë pjesëmarrësve dhe do të publikohet në web faqen e BQK-së, të destinuar për këtë ekip (<http://www.bqk-kos.org/?cid=1,59,55>)
- Para takimit të ardhshëm do dërgohen propozime nga secili pjesëmarrës/institucion për reduktimin e pagesave në para të gatshme
- Kërkesat, propozimet apo opinionet për reduktimin e pagesave në para të gatshme mund të dërgohen me shkrim në çdo kohë në e-mail adresën: [paymentsystems@bqk-kos.org](mailto:paymentsystems@bqk-kos.org). Këto propozime do të analizohen dhe përgjigjet ipen menjëherë (përmes grupit) dhe në mënyrë të organizuar prezantohen edhe mbledhjet e radhës.
- Të kryhet analiza mbi kostot dhe përfitimet për komunitetin e biznesit